



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/40  
Datë: 29.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 korrik 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Profesionet e Rregulluara.
2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria -Vlada-Government*

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju -  
Ministry of Education Science and Technology

---

**KONCEPT DOKUMENT  
PËR PROFESIONET E RREGULLUARA**

## Hyrje

Draft koncept dokumenti (në tekstin e mëtejme KD) për Profesionet e Rregulluara, është përgatitur duke marrë parasysh dokumentet strategjike që janë miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si në vijim:

1. Deklarata e Politikave Prioritare Afatmesme 2015-2017
2. Plani i Veprimit i Vizionit të Zhvillimit Ekonomik

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, në mbështetje të programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018, planit vjetor të punës së MASHT-it mbi objektivat e përgjithshme të arsimit të Republikës së Kosovës si dhe përcaktimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për trajtimin e sektorit të arsimit si prioritet themelor për zhvillimin e vendit, e trajton me prioritet të lartë rregullimin juridik të fushës së profesioneve të rregulluara në Republikën e Kosovës, si instrument shumë i rëndësishëm i rregullimit të sferës së profesioneve të caktuara në vendin tonë, si dhe duke analizuar përvojat më të mira të vendeve të rajonit në drejtim të ngritjes dhe zhvillimit të arsimit, rrjedhimisht dinamikës së reformave në arsim.

## Kapitulli 2

### Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Çështja e trajtuar me këtë KD, është fusha e profesioneve të rregulluara në Republikën e Kosovës, ku përcaktohen kriteret për ushtrimin e disa profesioneve të rëndësishme, të cilat lidhen me mbrojtjen e interesit publik, të sigurisë publike dhe të shëndetit, duke respektuar parimin e shqyrtimit të pavarur dhe autonomisë e profesionistëve, mbrojtjen dhe garantimin e standardeve për disa profesione të rëndësishme, në mënyrë që ushtrimi i tyre të bëhet prej personave të kualifikuar, të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në këtë fushë me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, është përgjegjëse për krijimin e politikave arsimore dhe konfirmon se deri më tani, nuk është ndërmarrë një iniciativë për nxjerrjen e një akti normativ për rregullimin e kësaj fushe, ndërsa pas pëlqimit tuaj do të kujdeset që ky akt të hartohet në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare.

1. Përmasat dhe kohëzgjatja e problemeve janë të mëdha, ndërsa kohëzgjatja e zbatimit do të zgjasë 2-3 vite varësisht nga mundësitë financiare.
2. Përmasat e ndikimit do të shtrihen në gjithë vendin.
3. Grupet që ndikohen më së tepërmi janë institucionet e arsimit të lartë, por edhe institucione të tjera të arsimit parauniversitar, institucione dhe ndërmarrje të ndryshme



gjatë përgatitjes së kuadrove të profesioneve të rregulluara si dhe gjatë pranimit në punë.

4. Përmasat e ndikimit do shtrihen në gjithë vendin me theks të veçantë në qytetet e mëdha të vendit.

5. Janë të prekura me dhjetëra institucione të arsimit të lartë, por edhe institucione të tjera të arsimit parauniversitar si dhe institucione dhe ndërmarrje të ndryshme gjatë përgatitjes së kuadrove të profesioneve të rregulluara si dhe gjatë pranimit në punë. Institucionet dhe ndërmarrjet që janë të prekura, janë ato që krijojnë por edhe punësojnë disa profesione, por ato nuk mund të përshkruhen të gjitha, sepse është një gamë e gjerë e tyre. Më poshtë po i përmendim disa profesione si : mjekut; stomatologut; farmacistit; infermierit; mamisë; fizioterapistit; veterinerit; arkitektit; inxhinierit; mësimdhënësit; psikologut, punëtori social. Profesione të rregulluara janë edhe profesionet e përcaktuara si të tilla me ligje të tjera, të veçanta.

6. Trendi i realizimit në përmasa të plota është synim për vitin e ardhshëm, por ne mendojmë se kjo do të kap periudhën prej 5 vitesh.

## Politika aktuale

Kjo fushë nuk është e rregulluar me asnjë akt juridik. Politika aktuale në këtë fushë është se me asnjë akt juridik nuk është e rregulluar kjo fushë. Përgjegjës për politikën e tillë është: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, institucionet e arsimit, Agjencia përkatëse për Profesionet e Rregulluara dhe institucionet dhe ndërmarrjet që krijojnë dhe punësojnë kuadro të profesioneve të rregulluara. Deri më sot, politika nuk e ka parë të arsyeshme që këtë fushë ta normoi, por duke pasur parasysh përvojat e vendeve të tjera në këtë fushë, ministri aktual e ka parë si shumë të domosdoshëm rregullimin me akt normativ të kësaj fushe. Këtë fushë ka kompetencë ta rregulloj MASHT, por deri më tani nuk ka pasur veprime të cilat do ta rregullonin këtë fushë. Profesionet janë njohur ashtu siç i kanë dhënë institucionet që kanë dhënë këto profesione. Me rregullimin e kësaj fushe do të krijohet një Agjencia që do merret me dhënien e Licencës së Profesioneve të Rregulluara.

Problemet kryesore për mos rregullimin e kësaj fushe kanë qenë ato se institucionet përkatëse ose ndërmarrjet kanë pasur probleme të shumta gjatë pranimit të kuadrit të ndryshëm në punë, sepse nuk ka ekzistuar një autoritet i vetëm që do të jepte licencë për profesionet e caktuara, prandaj shumë herë ka pasur paqartësi në këtë fushë dhe kontestime të ndryshme që kanë bërë që të ngecen procedurat.

Nuk ka asnjë akt nënligjor që e rregullon fushën për profesionet e rregulluara, por institucionet e arsimit që krijojnë kuadro të profesioneve të rregulluara dhe ato që punësojnë janë përgjegjëse. Por, institucionet e arsimit që krijojnë kuadro të profesioneve të rregulluara kanë për obligim përgatitjen e kuadrove, por sipas nevojës edhe pranimin në punë të këtyre kuadrove. Sipas nevojës pranimin në punë të këtyre kuadrove, mund ta bëjnë edhe ndërmarrjet.

Deri më tani nuk janë marrë kurrfarë veprimesh për këtë çështje. Asnjë veprim nuk ka pasur në të kaluarën dhe asnjë ligj në Kosovë nuk e rregullon këtë fushë. Nuk mund të flasim për mangësi kur nuk e kemi të rregulluar këtë fushë me asnjë akt ligjor dhe nënligjor.

### **Programi aktual**

Shpenzimet aktuale:

MASHT, aktualisht nuk është duke shpenzuar fare në këtë program sepse ky program do bëhet funksional për herë të parë në vendin tonë.

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale.

Politika aktuale në këtë fushë është se me asnjë akt juridik nuk është e rregulluar kjo fushë. Përgjegjës për politikën e tillë do të jenë:

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë, institucionet e arsimit të lartë dhe Agjencinë për Provimin Shtetëror për Profesionet e Rregulluara;

### **Përvoja e shteteve të tjera**

Gjatë punës së hartimit të Projektligjit do të konsultojmë edhe Ligje të vendeve të tjera anëtare të BE.

Për model të punës kemi marrë Ligjin për Profesionet e Rregulluara të Shqipërisë.

Qasja që ka ndjekur Shqipëria në fushën e profesioneve të rregulluara, i përshtatet më shumë Kosovës, prandaj vlerësojmë se kjo

do të jetë qasja më e suksesshme për vendin tonë. Shqipëria ka paraparë disa profesione të rregulluara ku përmes Agjencisë për Provimin Shtetëror për Profesionet e Rregulluara ka paraparë procedurat e kësaj fushe. Profesionet e Rregulluara në Shqipëri kanë krijuar një perspektivë dhe stabilitet në tregun e punës, me çka edhe Kosova do të përfitonte shumë në tregun e punës dhe në plotësimin e standardeve evropiane në këtë fushë.



### **Kapitulli 3**

#### **Synimet dhe objektivat**

Trajtimi i sfidave dhe problemeve aktuale, me theks të veçantë në arsimin e lartë si dhe standardizimi i disa profesioneve, me qëllim të ngritjes jo vetëm të cilësisë në arsim, por edhe të arritjes së një sistemi funksional dhe efektiv të menaxhimit të profesioneve të caktuara si dhe lehtësimit në orientimin profesional në karrierë, përshtatjen e kurrikulave, nevojave të tregut të punës, duke rritur punësimin e të diplomuarve dhe ndryshimin e imazhit të arsimit të lartë të Republikës së Kosovës, do të arrihet vetëm përmes hartimit dhe jetësimit të politikave legjislative efektive dhe të qëndrueshme.

Objektivat:

Objektiv i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të profesioneve të rregulluara në Republikën e Kosovës.

Duhet të ndryshohet gjendja ekzistuese sepse nuk kemi fare profesione të rregulluara, prandaj kemi shumë probleme në praktikë.

Gjërat e matshme janë profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës.

Objektivi është i pranueshëm, sepse është prioritet i MASHT, rregullimi i profesioneve.

Objektivi është i arritshëm edhe pse Kërkohet një kosto financiare dhe një përkushtim i të gjithë akterëve relevantë që do merren me këtë çështje.

Objektivi do arrihet në periudhën prej 3 vitesh pas rregullimit me ligj të profesioneve të rregulluara.

### **Kapitulli 4**

#### **Opsione**

**Opsioni 1:** Opsioni status quo (asnjë ndryshim), ruajtja e gjendjes ekzistuese.

Mos rregullimi i kësaj fushe ka pasojat e veta sidomos në tregun e punës. Supozime me vazhdimin e status quo janë bërë duke shikuar gjendjen aktuale e cila nuk ofron zgjidhje konkrete dhe praktike për profesionet e rregulluara. Status quo zbatohet duke mos ndërmarrë asnjë veprim në këtë fushë.

Nuk mund të vazhdohet një politikë e tillë e cila nuk krijon cilësi, sepse nuk ka kritere të punësimit, pasi që nuk ka profesione të Rregulluara. Institucione të ndryshme private krijojnë kuadro që profesionet e tyre nuk janë të barasvlershme me ato publike

## **Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese.**

Ndryshimi i politikës aktuale do të bëhet duke aprovuar Ligj të ri , me të cilin do të rregullohej kjo fushë e rëndësishme.

Ligji i ri do të rregulloj këto profesione në Republikën e Kosovës: Profesionin e mjekut; stomatologut; farmacistit; infermierit; mamiisë; fizioterapistit; veterinerit; arkitektit; inxhinierit; mësimdhënësit; psikologu, punëtori social; profesione të rregulluara do të jenë edhe profesionet e përcaktuara si të tilla me ligje të tjera, të veçanta.

Këto profesione në të shumtën e rasteve janë diskutuar dhe kontestuar, prandaj ndryshimi që do bëhet do jetë i rëndësishëm.

Zbatimi i Ligjit do bëhet nga MASHT dhe institucionet tjera relevante si dhe nga Agjencia për Provimin e Profesioneve të Rregulluara

Nuk kemi paraparë dënime për mos respektim sepse vetë mos marrja e licencës për marrje të diplomës ose certifikatës për profesionin e rregulluar është sanksionues sepse pa të nuk mund të krijohet marrëdhënia e punës.

Do të ketë nevojë për trajnime, personel dhe mjete financiare për Agjencinë.

Ka nevojë për program të ri për profesionet e rregulluara , përgjegjës do të jetë MASHT, Agjencia për Provimin Shtetëror për Profesionet e Rregulluara (APSHPRR) dhe akterët tjerë, mjetet financiare për vit mesatarisht 771,940 €, përfituesit e profesioneve të rregulluara.

Nevojitet një fushat edukimi ose informimi i akterëve, fushata do bëhet ne debate të shumta me akterët, informata dhe njoftime përmes mjeteve të informimit. Fushata do zhvillohet nga APSHPRR dhe MASHT qe nga momenti i miratimit të Ligjit e deri ne zbatimin e plotë të tij. Akterët kryesor janë përfshirë që në hartimin e Koncept dokumentit do të jenë pjesë e hartimit të ligjit. APSHPRR dhe MASHT, në bashkëpunim me institucionet tjera relevante janë përgjegjës për zbatimin e ligjit të ri. MASHT do kontribuoj në krijimin e organeve kompetente, ndërsa APSHPRR në njohjen e profesioneve të rregulluara. Nevojiten përgatitjet për themelimin e APSHPRR dhe pastaj APSHPRR do merret me përgatitjen e institucioneve kompetente dhe individëve përfitues të profesioneve të rregulluara.

## **Opsioni 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit.**

Nuk mund të mbetet gjendja ekzistuese sepse është e domosdoshme nevoja e rregullimit të fushës së profesioneve të rregulluara. MASHT dhe APSHPRR.



Duhet të zhvillohen trajnime për zbatimin e ligjit. Burime shtesë për krijimin e APSHPRR në shumën e përcaktuar në Deklaratën Financiare.

### Opsionet tjera

1. Opsionet tjera si ato:

1.1. Ekonomik do të jetë sepse fituesit e profesioneve të rregulluara do të jenë të lidhura

me tregun e punës sepse ata do fitojnë mundësinë që gjatë fitimit të profesionit të rregulluar punon së paku me 50% të pagës së vendit të punës.

1.2. Stimulues sepse nxit përfituesit e profesioneve të rregulluara që të arrijnë kualifikimin

duke përfituar së paku me 50% të pagës së vendit të punës.

1.3. Vullnetar, sepse përfituesit e profesioneve të rregulluara duke pasur parasysh përfitimet edhe në ngritje profesionale edhe përfitime financiare vullnetarisht do pranoin profesionet e rregulluara.

2. Do funksionojnë mirë sepse interesi edhe i institucioneve edhe i përfituesve është reciprok.

3. Do të zbatohen në koordinim të plotë në mes institucioneve dhe përfituesve.

### Kapitulli 5. Përmbledhje e opsioneve

Përmbledhje e opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	1. Mosrregullimi i kësaj fushe ka pasojat e veta sidomos në tregun e punës. 2. Supozimet me vazhdimin e status quo janë bërë duke shikuar gjendjen aktuale e cila nuk ofron zgjidhje konkrete dhe praktike për profesionet e rregulluara.	1. Ndryshimi i politikës aktuale do të bëhet duke aprovuar Ligj të ri. 2. Ligji i ri do të rregulloj këto profesione në Republikën e Kosovës :	1. Nuk mund të mbetet gjendja ekzistuese sepse është e domosdoshme nevoja e rregullimit të fushës së profesioneve të rregulluara. 2. MASHT dhe APRR. 3. Duhet të zhvillohen trajnime për zbatimin e ligjit. 4. Burime shtesë për krijimin e APRR në shumën e përcaktuar



	Status quo zbatohet duke mos ndërmarrë asnjë veprim në këtë fushë.	mjekut; stomatologut; farmacistit; infirmierit; mamisë; fizioterapistit; veterinerit; arkitektit; inxhinierit; mësimdhënësit; Psikologut, punëtori social; Profesione të rregulluara do të jenë edhe profesionet e përcaktuara si të tilla me ligje të tjera, të veçanta.	në Deklaratën Financiare.
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar	Nuk mbulon qytetas sektor	Do mbuloi popullsi dhe sektor te caktuar	Personave që marrin profesionet e rregulluara në tërë vendin.
Karakteristikat e zbatimit-kush është përgjegjës-një resor i Qeverisë	Nuk ka përgjegjës	Do të jenë: MASHT, APRR dhe institucionet të cilat krijojnë kuadër të	MASHT, APRR dhe institucionet të cilat krijojnë kuadër të profesioneve të rregulluara.

(cili), sektor privat, qytetarët		profesioneve të rregulluara.	
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	Nuk ka përgjegjës	Do të jenë: MASHT, APRR dhe Institucionet të cilat krijojnë kuadër të profesioneve të rregulluara	MASHT, APRR dhe institucionet të cilat krijojnë kuadër të profesioneve të rregulluara.
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Nuk ka ligje dhe akte nënligjore që duhet të të ndryshohen	Do të miratohet ligji dhe aktet nënligjore	Duhet të nxirret ligj i ri.
Stimulimet ose mos stimulimet ekonomike-subvencionet ose taksat	Nuk ka	Do të ketë	Pritet stimulimi ekonomik sepse shumë profesione do rregullohen dhe lidhje me tregun e punës do të jetë shumë më e avancuar.
Fushat e edukimit dhe komunikimit	Nuk ka	Do të ketë	Edukimi dhe komunikimi i hapur me të gjitha institucionet dhe kandidatët relevant që marrin profesionet e rregulluara
Udhëzimet dhe kodet	Nuk ka	Do të ketë	Udhëzime do t'u jepen të gjithë akterëve që merren me fushën e profesioneve të rregulluara.



Afatet kohore-kur hyn në fuqi opsioni	Nuk ka	Do të ketë	Opsioni pritet që të fillojë të hyjë në fuqi në bazë të afateve të cilat do përcaktohen në dispozitat kalimtare të ligjit, respektivisht në momentin e krijimit të kushteve financiare për zbatim të politikës.
---------------------------------------	--------	------------	---

## Kapitulli 6. Analiza e opsioneve

### Përfitimet në tri opsionet janë:

Opsioni 1: status quo

Nga ky opsion nuk përfitohet asgjë sepse situata e tillë nuk i kontribuon krijimit të kuadrove të profesioneve të rregulluara, të cilat do ti ndihmonin zhvillimit ekonomik të vendit. Prandaj, nga gjendja e tillë nuk përfiton askush në nivel vendi, përkundrazi pëson ekonomia e vendit, e cila nuk krijon kuadro të kualifikuara dhe të përgatitura për tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese.

Në mungesë të legjislacionit adekuat, për të evituar problemet dhe sfidat e tregut të punës dhe në respektim të plotë të autonomisë akademike dhe financiare të bartësve të arsimit të lartë, nevoja për qasje dhe reforma të reja në arsim, tashmë është më se e domosdoshme, rrjedhimisht instrumenti më i qëlluar për monitorimin dhe menaxhimin e arsimit gjithëkombëtar, duke rregulluar fusha specifike të profesioneve, do të ndikonte fuqishëm në ngritjen e cilësisë dhe në realizimin e reformave të parapara edhe në programin qeveritar.

Ne do dimë se përfitimet janë arritur në momentin që personat marrin diplomat ose certifikatat se kanë kryer një profesion të rregulluar me të cilin do sigurojnë punë brenda dhe jashtë vendit.

Ndikimet në integrimet evropiane do të jenë më të lehta me rregullimin e profesioneve të caktuara.

Përfitimi i drejtpërdrejtë do jetë krijimi i profesionistëve për tregun e punës.

Opsioni 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Ndryshimi i qasjes ekzistuese duhet të ndodh domosdo sepse rregullimi me ligj i profesioneve do të jetë shumë i rëndësishëm për vendin për arsyt si në vijim:

Përgatitja e kuadrove deri në diplomimin ose certifikimin e tyre, të cilët do të sigurojnë punë në tregun e punës brenda dhe jashtë vendit.

Me rregullimin e profesioneve të caktuara ndikimet në integrimet evropiane do të jenë më të lehta, sepse profesionistët janë kuadro të përgatitura për tregun evropian të punës.

Prandaj, koordinimi dhe bashkërendimi i opsionit të dytë dhe të tretë, do t'i realizonte objektivat e parapara.

Pasojat negative

1. Pasojat nga Opsioni 1 status quo- janë:

Nga ky opsion nuk përfitohet asgjë sepse situata e tillë nuk i kontribuon krijimit të kuadrove të profesioneve të rregulluara të cilat do ti ndihmonin zhvillimit ekonomik të vendit. Po ashtu inkuadrimi në BE do të jetë i vështirë.

2. Pasojat nga opsioni 2 ndryshimi i politikës ekzistuese janë:

Edhe nga opsioni i dytë: Ndryshimi i politikës ekzistuese, nuk përfitohet ajo e cila dëshirohet të arrihet .

3. Pasojat nga opsioni 3 ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit.

Opsioni 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit nuk ka pasoja negative përkundrazi shkakton pasoja pozitive dhe qasje të lehtë në integrimet evropiane.

Efekti shpërndarës

1. Sektorët që do të preken janë publik dhe Privat, të cilët merren me krijimin e kuadrove të profesioneve të rregulluara.

2. Përfitimet do të jenë të njëjta për tërë Republikën e Kosovës.

3. Ndikimet po ashtu nuk kanë ndryshime respektivisht dallime në mes gjinive.



## Kapitulli 7 Konsultimi

### 1. Konsultimi me ekspert si në vijim:

- 1.1. Eksperti prof. But Dedaj prof. i F. Ekonomik ka thënë se rregullimi i profesioneve të caktuara me ligj, do të jetë i rëndësishëm për vendin sepse do hiqen problemet ekzistuese rreth njohjes ose mosnjohjes së disa profesioneve.
- 1.2. Eksperti dr. Gani Bajraktari, poashtu ka thënë se rregullimi i profesioneve të caktuara me ligj do të jetë i rëndësishëm duke potencuar fushën e shëndetësisë.
- 1.3. Prof. Avdullah Aliu, ka thënë se rregullimi i profesioneve të caktuara me ligj do të jetë i rëndësishëm.
- 1.4. Ekspertja Ferdije Zhushi, ka thënë se rregullimi i profesioneve të caktuar me ligj do të jetë i rëndësishëm dhe do ta ndihmonte arsimin dhe tregun e lirë të punës.
- 1.5. Prof. Nizafere Limani, ka thënë se rregullimi i profesioneve të caktuara me ligj do të jetë i rëndësishëm për Republikën e Kosovës.
- 1.6. Prof. Hysen Bytyqi, këshilltar politik i ministrit, ka thënë se rregullimi i profesioneve të caktuara me ligj do të jetë i rëndësishëm.
- 1.7. Prof. Zenun Halili, këshilltar politik i ministrit, ka thënë se rregullimi i profesioneve të caktuara me ligj do të jetë i rëndësishëm dhe se duhet nxjerr sa më parë ligjin.
- 1.8. Drita Kadriu, ka thënë se Rregullimi i profesioneve të caktuara me ligj do të jetë i rëndësishëm për vendin sepse do hiqen problemet ekzistuese rreth njohjes ose mosnjohjes së disa profesioneve me çka do përafrohemi me standardet e BE.
- 1.9. Isni Kryeziu, ka thënë se rregullimi i profesioneve të caktuara me ligj do të jetë i rëndësishëm për Republikën e Kosovës.
- 1.10. Bujar Gallopeni, ka thënë se rregullimi i profesioneve të caktuara me ligj do të jetë i rëndësishëm.
- 1.11. Teuta Danuza, ka thënë se rregullimi i profesioneve të caktuara me ligj do të jetë i rëndësishëm.
- 1.12. Bekim Samadraxha, është shprehur se ligji do të jetë i rëndësishëm.

2. Konkluzion i të gjithë ekspertëve ishte se kjo fushë duhet rregulluar me Ligj, sepse me akte të tjera nënligjore nuk mund të rregullohet dhe se situata aktuale është e pa favorshme për rregullimin e fushës së profesioneve të rregulluara.

Diskutimi Paraprak është mbajtur në pajtim me nenin 7 të Rregullores së Punës së Qeverisë, me institucionet dhe akterët tjerë kompetent është mbajtur nga dt. 12.05.2015

deri me dt. 01.06.2015. MF ka dhënë opinionin ligjor për Deklaratën Financiare, nuk ka pasur Komentë tjera.

Diskutimi Publik me Institucionet dhe akteret tjerë kompetent është mbajtur nga dt. 10.06.2015 deri me dt. 30.06.2015. nuk ka pasur Komentë.

Komentet e SKQ-janë pranuar plotësisht.

## Kapitulli 8

### Krahasimi i opsioneve (vlerëso pasojat e secilit opsion)

Nëse do të vendoset për alternativën e statusit ekzistues, do të vështirësohet procesi i ngritjes së cilësisë në arsimin e lartë, do të vështirësohet, gjithashtu edhe orientimi i kuadrove drejt nevojave të tregut.

Nëse vendoset për opsionin e dytë, do të krijohen mekanizmat efikas dhe efektiv për zhvillimin dhe avancimin, jo vetëm të sferës së arsimit, por do të kishte impakt edhe në zhvillimin e përgjithshëm ekonomiko-social të vendit.

Pasojat e të tri opsioneve janë:

Opsioni 1: status quo-

Nga ky opsion nuk përfitohet asgjë sepse situata e tillë nuk i kontribuon krijimit të kuadrove të profesioneve të rregulluara të cilat do ti ndihmonin zhvillimit ekonomik të vendit. Prandaj nga gjendja e tillë nuk përfiton askush në nivel vendi, përkundrazi pëson ekonomia e vendit e cila nuk krijon kuadro të kualifikuara dhe përgatitura për tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese.

Në mungesë të legjislacionit adekuat, për të evituar problemet dhe sfidat e tregut të punës dhe në respektim të plotë të autonomisë akademike dhe financiare të bartësve të arsimit të lartë, nevoja për qasje dhe reforma të reja në arsim, tashmë është më se e domosdoshme, rrjedhimisht instrumenti më i qëlluar për monitorimin dhe menaxhimin e arsimit gjithëkombëtar, duke rregulluar fusha specifike të profesioneve, do të ndikonte fuqishëm në ngritjen e cilësisë dhe në realizimin e reformave të parapara edhe në programin qeveritar. Prandaj, koordinimi dhe bashkërendimi i opsionit të dytë dhe të tretë, do t'i realizonte objektivat e parapara.



Ne do të dimë se përfitimet janë arritur në momentin që personat marrin diplomat ose certifikatat se kanë kryer një profesion të rregulluar me të cilin do të sigurojnë punë brenda dhe jashtë vendit.

Ndikimet në integritime evropiane do të jetë më i lehtë me rregullimin e profesioneve të caktuara.

Përfitimi i drejtpërdrejtë do jetë krijimi i profesionistëve për tregun e punës.

### Opsioni 3. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Ndryshimi i qasjes ekzistuese duhet të ndodh domosdo, sepse rregullimi me ligj i profesioneve do të jetë shumë i rëndësishëm për vendin për arsyet si në vijim:

Përgatitja e kuadrove deri në diplomimin ose certifikimin e tyre, të cilët do të sigurojnë punë në tregun e punës brenda dhe jashtë vendit.

Me rregullimin e profesioneve të caktuara, ndikimet në integritime evropiane do të jenë më të lehta sepse profesionistët janë kuadro të përgatitura për tregun evropian të punës. Prandaj, koordinimi dhe bashkërendimi i opsionit të dytë dhe të tretë, do t'i realizonte objektivat e parapara.

### Pasoja negative

Pasoja nga Opsioni 1 status quo- janë:

Nga ky opsion nuk përfitohet asgjë sepse situata e tillë nuk i kontribuon krijimit të kuadrove të profesioneve të rregulluara të cilat do t'i ndihmonin zhvillimit ekonomik të vendit. Poashtu, inkuadrimi i BE do të jetë i vështirë.

Pasoja nga opsioni 2, ndryshimi i politikës ekzistuese janë:

Edhe nga opsioni i dytë ndryshimi i politikës ekzistuese, nuk përfitohet ajo e cila dëshirohet të arrihet .

Pasoja nga opsioni 3, ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit.

Opsioni 3, ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit nuk ka pasojë negative përkundrazi shkakton pasojë pozitive dhe qasje të lehtë në integritime evropiane.

### Efektet shpërndarëse

1. Sektorët që do të preken janë publik dhe privat dhe do të merren me krijimin e kuadrove të profesioneve të rregulluara.

1. Përfitimet do të jenë të njëjta për tërë Republikën e Kosovës.
  2. Ndikimet po ashtu nuk kanë ndryshime respektivisht dallime në mes gjinive.
- Efekti financiar është përcaktuar në Deklaratën Financiare të më lartshënuar.

## Kapitulli 9. Rekomandimi

1. Bazuar në këtë koncept dokument (pas miratimit me Vendim nga Qeveria), për futje në agjendën legislative të vitit 2015, MASHT, rekomandon miratimin e Projektligjit për Profesionet e Rregulluara.
2. PPRR do miratohet nga MASHT;
3. PPRR do të miratohet në vitin 2015;
4. Kostoja është përcaktuar, në Deklaratën Financiare, e cila është mbuluar me opinionin ligjor të MF

## Kapitulli 10. Komunikimi

Komunikimi dhe bashkëpunimi ka qenë gjithëpërfshirës në mënyrë vertikale dhe horizontale, duke e zbatuar me përpikëri legjislacionin në fuqi.

Ministria ka zhvilluar një varg aktivitete me qëllim të arritjes së gjithë përfshirjes. Qëllimi kryesor i planit të veprimit të komunikimit dhe informimit ishte vetëdijesimi i palëve të interesit dhe publikut për rëndësinë e ligjit, që është realizuar përmes:

1. Njoftimit në media dhe spotet televizive;
2. Publikimeve të ndryshme, dhe Informata në ueb-faqen zyrtare të MASHT-it.

1. Titulli i propozimit: KËRKËSË PËR KOSTO BUXHETORE PËR PROJEKTLIGJIN PËR PROFESIONET E RREGULLUARA		2. Organizata buxhetore: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë			
3. Emri i kontaktit dhe pozita: Drejtor ekzekutiv financiar: Fehmi Zylfiu		4. Detajet e kontaktit: Nr. tel. 044/116/944 038/213/128			
5. Qëllimi i kërkesës/veprimit që propozohet (cili është rekomandimi): MIRATIMI I KONCEPTDOKUMENTIT: PROJEKTLIGJI PËR PROFESIONET E RREGULLUARA					
6. Tregoni se si këto rekomandime do t'i mbështesin Prioritetet e Qeverisë dhe të Ministrisë KËRKOJMË NGA QEVERIA, RESPKTIVISHT NGA MINISTRIA E FINANCIVE NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR PROJEKTLIGJIN PËR PROFESIONET E RREGULLUARA					
7. Implikimet financiare:		(000 euro)			
		Viti aktual 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
A. Kostoja totale e propozimit					
Paga & Mëditje		1,180,384	1,420,324	1,420,322	1,420,324
Mallra & Shërbime		2,254,824	2,768,822	2,684,822	2,684,822
Shpenzimet komunale		47,770	51,770	51,770	51,770



Subvencione & Transfere	959,448	281,448	281,450	281,450
Kapital	4,315,000	7,524,000	7,650,000	7,653,000
Gjithsej:	8,757,426	12,046,364	12,088,364	12,091,366
<b>B. Alokimi i aprovuar buxhetor që lidhet me propozimin</b>				
Paga & mëditje	1,180,384	1,180,384	1,180,384	1,180,384
Mallra & shërbime	2,254,824	2,264,822	2,264,822	2,264,822
Shpenzimet komunale	47,770	47,770	47,770	47,770
Subvencione & transfere	959,448	281,448	281,450	281,450
Kapital	4,315,000	7,500,000	7,653,000	7,653,000
Gjithsej:	8,757,426	11,274,424	11,424,424	11,427,426
<b>C. Ndryshimi nga alokimi i aprovuar buxhetor (A-B)</b>				
Paga & mëditje				
Mallra & shërbime		239,940 €	239,940 €	239,940 €
Shpenzimet komunale		504,000 €	420,000 €	420,000 €
Subvencione & transfere		4,000 €	4,000 €	4,000 €
Kapital		0.00 €	0.00 €	0.00 €
Gjithsej:		24,000 €	0.00 €	0.00 €
		771,940 €	663,940 €	663,940 €
<b>D. Rritja/ zvogëlimi i gjenerimit të të ardhurave (+/-)</b>				
		771,940 €	663,940 €	663,940 €
<b>E. Pjesa e rritjes/zvogëlimit që propozohet të mbahet nga organizata buxhetore</b>				
<b>F. A ekzistojnë burime potenciale të mbështetjes nga donatorët?</b> Burimi: Parashihet financim nga donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë.				
<b>8. Rritja Neto/ zvogëlimi në numrin e stafit</b>		36	0.00	0.00
<b>9. Cilat garanci, hua apo obligime të tjera aktuale apo të rastit do të krijohen për Qeverinë?</b>				
KONCEPTDOKUMENT: PROJEKTLIGJI PËR PROFESIONET E RREGULLUARA KRIJON OBLIGIME PËR QEVERINË, POR NË DISPOZITAT KALIMTARE ËSHITË PARAPARË QË OBLIGIMET E KËTIJ LIGJI TË REALIZOHEN SIPAS AFATEVE TË PËRCAKTUARA NË KËTO DISPOZITA .				
<b>10. A është propozimi në pajtim me Memorandumin e Politikave Ekonomike dhe Fiskale? Nëse jo, ofroni një sqarim.</b> Po				
<b>11. Tregoni nëse ky formular shoqërohet nga përshkrimi narrativ i bazës për kalkulimet e kostos/të hyrave të paraqitura më lartë:</b>  PO X ; (Nëse Po, atëherë i bashkëngjitni formatit) JO ____.				
<b>12. Aprovimi/Data:</b> Haki Sfishta		Prof. dr. Arsim Bajrami		
_____ / ____ / 2015		_____ / ____ / 2015		
Nënshkrimi i Sekretarit të përgjithshëm apo shefit të organizatës buxhetore		Nënshkrimi i Ministrit		
Dita / Muaji / Viti		Dita / Muaji / Viti		
<b>13. Vërtetimi nga Ministria e Financave që vlerësimet e dhëna më lartë janë të sakta.</b>				
_____		_____		
Nënshkrimi		Dita / Muaji / Viti		
<b>14. Komentet shtesë nga Ministria për Ekonomi &amp; Financa:</b>				